



Prishtinë, 14 tetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_853_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15, dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 Detyrat dhe përgjegjësitë e OST, dhe Neni 19 paragrafi 4 dhe Nenit 22 paragrafi 10 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 05-L-085);
- Dispozitave të nenit 1.8 të Rregullave të Tregut;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 16.03.2016 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit,

në seancën e mbajtur me datë 14.10.2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** dokumenti **Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit**
- II. **Kalkulimet për qëllim të imbalancave deri më 31 dhjetor 2016 do të bëhen pa pasur implikime financiare (dry run).**

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16 mars 2016 ka pranuar nga KOSTT kërkesën për aprovim të dokumentit **Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit**. Dokumenti është punuar në bazë të Rregullave të Tregut të aprovuara nga ZRRE.
- Fillimisht KOSTT ka dërguar dokumentin për shqyrtim me 08 korrik 2015. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar por edhe përmes takimeve me përfaqësuesit e KOSTT-it ku janë përfshirë apo sqaruar çështjet e ngritura. Më vonë dokumenti është dërguar për komentim të palët e interesuara, konsulenca dhe Sekretariati i komunitetit të energjisë, dhe përfundimisht pas përfshirjes së komenteve të arsyeshme nga të gjitha palët, dokumenti



është dërguar për aprovim.

- Me datë 16.03.2016 KOSTT ka dorëzuar versionin e përmirësuar të dokumentit për aprovim në ZRRE. Më tej janë bërë ndryshime tjera dhe në tetor 2016 KOSTT ka dërguar versionin final: **Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit.**
- ZRRE ka analizuar dokumentin, dhe konsideron se dokumenti përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke aprovuar dokumentin: **Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit.**

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar